

FJALA E DEPUTETES ENSLEMLVERA ZAKE

E ENJTE 15 NËNTOR 2021

E nderuar zonja Kryetare e seancës,

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Është sa privilegj, po aq edhe përgjegjësi politike, publike, ekonomike, sociale dhe personale të diskutosh në këtë sallë për çështjen më të rëndësishme të çdo viti kalendarik parlamentar, për buxhetin e qeverisë, për buxhetin më të madh në historinë e shtetit shqiptar që financoi programin e qeverisë, edhe pse i shoqëruar nga dy goditje të përmasave të mëdha, nga tërmeti dhe pandemia, që çoi në rënie të ndjeshme të ekonomisë botërore, rrjedhimisht, preku ndjeshëm disa sektorë edhe në Shqipëri. Objektivi kryesor i projektbuxhetit të vitit 2022, siç edhe u paraqit nga ministrja e Financave, zonja Ibrahimaj, të cilën gjej rastin ta falënderoj dhe ta përgëzoj për punën intensive dhe tejet të detajuar lidhur me hartimin e buxhetit, të projektbuxhetit afatmesëm dhe të kuadrit makro-ekonomik, si dhe të gjithë kabinetin qeveritar, mbetet rimëkëmbja ekonomike. Ky vit nuk është një vit procedural i një legjislature të tretë që, normalisht, fillon me një program të ri qeverisës, i cili duhet të mbështetet në buxhet. Programi i qeverisë është tejet ambicioz dhe do ta zbatojmë atë duke ruajtur me rigorozitet kuadrin ligjor në fuqi për buxhetin, si dhe duke iu përmbajtur gjithçkaje që kërkohet nga Banka e Shqipërisë dhe FMN-ja, që është pikërisht konsolidimi i financave publike, proces i cili do të startojë gjatë vitit 2022. Duke qenë se shpejtësia e konsolidimit të financave publike kushtëzohet nga rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare dhe nevoja e përfundimit të procesit të rindërtimit, do të ndërmerren masa të nevojshme për rritjen e ritmit të konsolidimit fiskal, pra reduktimin e mëtejshëm të deficitit dhe borxhit publik.

Shpenzimet publike parashikohet të kapin vlerën 637,6 miliardë lekë ose 34,1% të produktit të brendshëm bruto. Edhe të ardhurat totale të buxhetit për vitin 2022 pritet të pësojnë një rritje prej 7,8% krahasuar me vitin 2021, duke arritur vlerën 536,8 miliardë lekë. Sipas projeksioneve të projektbuxhetit, deficitin buxhetor programohet të ulet në 5,4% të produktit të brendshëm bruto për vitin 2022, kundrejt nivelit 6,8% të pritur në vitin aktual. Për të mos u tejzgatur me statistika dhe shifra dhe pa dashur të përsëris zonzjën ministre dhe kolegët e tjerë, pyetjes së qytetarëve se çfarë do të përfitoj unë nga ky buxhet, do t'i përgjigjesha duke u vënë theksin në projektpropozimeve të mëposhtme: rritje e pagave minimale në masën më shumë se 30% nga 30 në 40 mijë lekë si për sektorin privat, ashtu dhe për atë publik, si dhe zhvendosja e kufirit të taksimit, pra nga 30 mijë në 40 mijë lekë për normën 13% dhe nga 150 në 200 mijë lekë për normën 23%, në kuadër të projektligjit "Për tatimin mbi të ardhurat", duke lehtësuar të gjithë të punësuarit pa përjashtim, në veçanti shtresat e mesme të të punësuarve, por duke ruajtur parimin e progresivitetit, që lidhet me atë që ai që fiton më shumë do të kontribuojë më shumë për mirëqenien e përbashkët, me fokus mbështetjen dhe fuqizimin e shtresës së mesme të shoqërisë. Numri i tatimpaguesve që do të përfitojnë nga kjo lehtësi tatimore është rreth 5900 qytetarë dhe shuma e përfitimit është në masën 23 mijë lekë në vit për çdo tatimpagues. Në total, barra tatimore e tatimpaguesve do të ulet me 1,37 miliardë lekë në vit. Do të

rriten pagat për mësuesit dhe mjekët në masën 6%, për punonjësit e policisë, si dhe do të ketë rritje pagash me 30% për ushtarakët. Po ashtu, bujqësia mbetet në fokusin e qeverisë shqiptare. Nga buxheti i vitit 2022 fermerët përfitojnë 12,7 miliardë lekë, nëpërmjet skemave shtesë për fermerët, rimbursimit të naftës, projektit të garancisë së kredisë për zonat rurale dhe garancisë sovrane për fermerët. Rritet me 10% norma ekonomike, trefishohet ndihma për gratë e trafikuar me fëmijë të mitur, si dhe dyfishohet ndihma për nënat me shumë fëmijë.

Po ashtu, parashikohen rritje të shpenzimeve për pagesën e papunësisë me 900 milionë lekë, për pagesën e aftësisë së kufizuar me 23,5 miliardë lekë dhe për pagesën e ish-të përndjekurve politikë me 1 miliard lekë. Investimet publike mbeten shtylla e dytë më e rëndësishme e këtij projektbuxheti, niveli i të cilave për vitin 2022 parashikohet të jetë 6,4% e GDP-së, nivel ky mjaftueshëm i lartë për përmirësimin e gjithanshëm të infrastrukturës së vendit, në interes të përshpejtimit të ritmit të rritjes ekonomike në afatmesëm dhe afatgjatë, si dhe në interes të rritjes së mirëqenies së shoqërisë. Lajm i mirë për të gjithë qytetarët është vijimi i projekteve infrastrukturore, të tilla si: Rruga e Arbrit, tuneli i Llogorasë, Unaza e jashtme e Tiranës, bajpasi i Shkodrës, segmenti Palasë-Dhërmi dhe Elbasan-Përrenjas-QafëThanë. Në buxhetin e vitit 2022, gjithashtu, përfshihen investime për portet e Durrësit dhe Vlorës, aeroportet e Vlorës dhe Sarandës, linjat hekurudhore Tiranë-Durrës dhe Tiranë-Rinas, si dhe do të akordohen 750 milionë lekë për spitalin rajonal të Fierit. Do të vijojë skema e librave falas në shkollë për nxënësit që vijnë nga shtresat në nevojë, skemë që do të zërohet, me efekt deri në nivelin e shkollës së mesme. Me një fond prej 250 milionë lekësh do të sigurohet transporti për mësuesit dhe nxënësit që banojnë larg shkollave. Me 700 milionë lekë të alokuara për projektet twining për universitetet, fokus tek të rinjtë mbetet dhe edukimi dhe është e shqeshme vëmendja e qeverisë ndaj arsimit të lartë.

Ajo që dua të theksoj si shtyllën e tretë më të rëndësishme në këtë projektbuxhet është reforma e digjitalizimit, si një faktor kryesor substancial, që nxit rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe ndihmon luftën kundër korrupsionit. Për shembull, digjitalizimi merr një tjetër dimension në investimet për projektin e dronëve dhe satelitëve, për sektorët e sigurisë dhe menaxhimit të territorit. Inkludimi, përfshirja, futja e teknologjisë së avancuar përmirëson rrënjësisht shërbimet kundrejt qytetarëve, duke shmangur burokracitë dhe duke rritur efikasitetin në shërbimet publike. Nuk mund të lë pa përmendur fondet e parashikuara për ndërtimin, fonde të cilat në projektbuxhet kapin vlerën 20 miliardë lekë, si dhe të nënvizoj vijimin e financimit të vaksinave anti-Covid për të gjithë shqiptarët, në vlerën 2,7 miliardë lekë. Projektbuxheti i vitit 2022 shoqërohet me 4 projektligje të paketës fiskale, fokusi i të cilave është konsolidimi i financave publike, rritja e të ardhurave të buxhetit, ulja graduale e deficitit buxhetor dhe borxhit publik. Një nga instrumentet më të sigurt për garantimin e rritjes së qëndrueshme të të ardhurave në raport me GDP-në është rishikimi i politikave fiskale ekzistuese, me qëllim korrigjimin e përjashtimeve tatimore dhe tarifave të reduktuara, të akorduara ndër vite, që janë vlerësuar si jo të efektshme dhe joefektive, bazuar edhe në rekomandimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar. Banka e Shqipërisë, pa dyshim, inkurajon zbatimin në kohë dhe me vendosmëri të masave që mbështesin formalizimin e ekonomisë. Prandaj finalizimi dhe zbatimi në një kohë sa më të shpejtë i strategjisë afatmesme të të ardhurave publike, që ka si synim thjeshtimin e sistemit tatimor, rritjen e qëndrueshmërisë së tij në kohë dhe shmangien e përjashtimeve tatimore joefektive mbetet prioritet për ne, sepse, e ritheksoj, rritja e formalizimit do të mundësojë rritjen e shkallës së grumbullimit të të ardhurave dhe përmirësimin e konkurrencës brenda dhe ndërmjet sektorëve të ekonomisë.

Për sa u takon konkretisht projektligjeve për taksën kombëtare dhe akcizën, në cilësinë e relatores, shkurtimisht po ju prezantoj propozimet dhe argumentet në të cilat mbështetet paketa për buxhetin. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.6112 “Për akcizën në Republikën e Shqipërisë”,

i ndryshuar”, synon të vendosë një nivel akcize për gazin e lëngshëm, pa diferencuar qëllimin e përdorimit. Aktualisht gazi i lëngshëm për përdorim për popullatën e kishte akcizën 0 lekë për litër, ndërsa gazi për përdorim si lëndë djegëse për automjetet kishte akcizë në nivelin 8 lekë për litër, duke krijuar kushte për konkurrencë jo të ndershme. Unifikimi i shkallës së akcizës për gazin e lëngshëm në masën 6 lekë për litër si për konsumatorin privat, ashtu edhe për tregtarin, do të shmangë abuzimet. Përvoja disavjeçare ka treguar se administrimi i deklarimit të destinacionit të përdorimit të këtij nënprodukti është shumë i vështirë, duke krijuar mundësi për shmangie nga pagesa e akcizës.

Madje, taksa e akcizës prej 8 lekësh për litër, në kushtet aktuale ka rënduar edhe mbi konsumatorët familjarë, për arsye të mosrespektimit të rregullave për tregtimin e bombolave të gazit. Ju bëj me dije se rritet shkalla e taksimit për akcizën për produktet e duhanit dhe nënprodukteve të tij, sipas një kalendari të skeduar për periudhën 2022-2026, me qëllim uljen e konsumit të duhanit dhe mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve, kufizimin e informalitetit në tregun e duhanit, si dhe përafrimin me legjislacionin kombëtar në disa parime të direktivave të Bashkimit Europian për akcizën. Heqja e rimbursimit për lëndët ndjekëse të konsumuara në serra, për ngrohje, për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, që përdoren për nevojat teknologjike të prodhimit të produkteve, është bërë me qëllim shmangien e trajtimeve preferenciale, jostandarde dhe aplikimin e frymës së parimeve të direktivës së BE-së për dhënien e preferencave të produkteve energjetike që përdoren si karburante, ndërsa vijon përjashtimi i karburantit për sektorin e peshkimit.

Ndërkohë, projektligji propozon dhe disa masa të tjera administrative dhe procedurale, të cilat konsistojnë në përfarimin e legjislacionit kombëtar me disa parime të direktivave të BE-së për akcizën, kryesisht në nivelin e taksimit dhe përmirësimin e procedurave administrative dhe vendimmarrëse. Gjithashtu, për sa i përket ligjit “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar”, konkretisht është vendosur një taksë për qumështin pluhur në masën 100 lekë për kilogramë, taksë për pijen e homogjenizuar barista 16 lekë për litër, taksë për hurrën e qumështit dhe kremën e qumështit, përkatësisht 150 lekë.

Kësisoj synohet mbështetja e fermerëve dhe përpunuesve vendas të qumështit dhe nënprodukteve të tij. Pikërisht në këtë frymë është propozuar edhe përjashtimi për pagimin e taksës së qumështit dhe taksës për hurrën e qumështit, të cilat kanë etiketën nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.